



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë:

31.03.2026

**A.nr.153/2026**

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës** – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurën sipas ankesës me numër A.nr.153/2026, të datës 09.02.2026, të parashtruar nga ankuesi A.Q, nga Prishtina, kundër organit të punësimit: Ministrisë së Drejtësisë, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafi 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, si dhe të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 31.03.2026, mori këtë:

**V E N D I M**

**Hedhet poshtë si e palejuar** ankesa me numër A.nr.153/2026 e datës 09.02.2026, e parashtruar nga ankuesi, A.Q.

**A r s y e t i m**

Ankuesi, A.Q (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi), më datë 09.02.2026 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është regjistruar nën shenjen A.nr.153/2026, kundër shkeljes së pretenduar disiplinore nga udhëheqësi i tij i drejtpërdrejtë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 13.02.2026 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën të Ministria e Drejtësisë, ndërsa, kjo e fundit, më datë 20.02.2026, ka dorëzuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kryetari i Këshillit, me datë 11.03.2026 ka nxjerrë Vendimin me shifër VK/2026 dhe numër protokolli:1273/2026, përmes të cilit ankesës së ankuesit nën shenjen A.nr.153/2026 të datës 09.02.2026 ia ka vazhduara afatin e vendimmarrjes edhe për dhjetë (10) ditë të tjera, ditë pune.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje administroi këto prova:** Ankesën me numër protokolli 694/2026 të datës 09.02.2026, e

parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës; Vendimin me shifër VK/2026 dhe numër protokolli:1273/2026; Kopjen e ID-së së ankuesit; Kërkesa e datës 03.11.2025; E-mailin e datës 03.11.2025 dërguar nga T.S për A.K me korrespondencën e bashkangjitur; Vendimin e datës 10.12.2025 të Komisionit Disiplinor të MD-së; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 13.02.2026; Përgjigja në ankesë e datës 20.2.2026; Akt Emërimit e datës 20.11.2024; Vendimin e datës 21.07.2025 të Komisionit Disiplinor.

Kolegji i Këshillit duke ju referuar shkresave të lëndës të parashtruar nga palët në procedurë ka konstatuar se ankesa e parashtruar nga ankuesi është e palejuar, *sepse*:

Nga administrimi i shkresave të lëndës, Kolegji i Këshillit konstatoi se ankuesi është i punësuar sipas Akt Emërimit me numër: 50/2024 të datës 20.11.2024, në pozitën “Zyrtar i lartë ligjor”, Divizioni për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Civile në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë.

Ndaj ankuesit, udhëheqësi i tij i drejtpërdrejtë me datë 03.11.2025 ka iniciuar procedurë disiplinore ndaj ankuesit me supozimin se i njëjti ka kryer shkelje të rënda disiplinore për shkak të mosrespektimit të orarit të punës, ndërsa Komisioni Disiplinor me datë 10.12.2025 ka nxjerrë vendimin Nr.05-1669/3 përmes të cilit, lënden e ankuesit e ka kthyer në ri-vlerësim të iniciuesit i procedurës disiplinore, respektivisht lëndën e ka kthyer te Udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankuesit, me arsyetimin se nuk ka prova bindëse se shkelja e supozuar është shkelje e rëndë disiplinore, me theksin se për çështje të tilla referuar nenit 8, pika të Rregullores nr.01/2024 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik, duhet të vendos udhëheqësi i drejtpërdrejtë i nëpunësit.

Po ashtu, Kolegji i Këshillit nga shkresat e lëndës gjeti se ankuesit edhe një herë tjetër gjatë vitit 2025 i ishte iniciuar procedurë disiplinore, ndërsa sipas Vendimit Nr.01/2025 të datës 21.07.2025 Komisioni Disiplinor e kishte pushuar procedurën e iniciuar disiplinore.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshill pretendon se udhëheqësi i tij i drejtpërdrejtë ka kryer shkelje të rëndë disiplinore me arsyetimin se e ka vënë në lajthitje organin e punësimit për shkak se ka dhënë informata të gabuara me rastet kur ndaj tij ka iniciuar procedurë disiplinore pasi që për asnjërin rast Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Drejtësisë nuk e ka gjetur përgjegjës ankuesin, me kërkesën që Këshilli të aprovoi ankesën e ankuesit ndërsa të iniciojë procedurë disiplinore dhe të konstatoi shkelje të rënda disiplinore ndaj udhëheqësit të drejtpërdrejtë të ankuesit.

Kolegji i Këshillit lidhur me pranueshmërinë e ankesës iu referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenit 27 paragrafi 3 ku përcaktohet se: “3. Nëpunësi civil ka të drejtë të paraqes ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës për çdo veprim apo mosveprim, që i

*cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto që burojnë nga marrëdhënia e punës në shërbimin civil’’, si dhe dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenit 14 ku përcaktohet se: “Palë në procedurën administrative mund të jetë çdo person fizik, person juridik apo grup personash me një interes të përbashkët: 1.1. me kërkesë të të cilit organi publik ka filluar procedura administrative; 1.2. ndaj të cilit ka filluar procedura administrative apo të cilit rezultati i procedurës administrative mund t’i cenojë të drejtat apo interesat juridike. 2. Palë në procedurën administrative janë, gjithashtu, dhe mbrojtësit e interesave publike të autorizuar me ligj të veçantë, si dhe mbrojtësit e interesave kolektive apo të interesave të gjera të publikut, nëse këto interesa mund të cenohen nga rezultati i procedurës administrative’’, si dhe nenit 124 paragrafi 1 të të njëjtit ligj me të cilin parashihet se: “Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim’’, dhe si rrjedhojë referuar dispozitave përkatëse ligjore, Kolegji i Këshillit, konstaton se me rastin e inicimit të procedurës disiplinore ndaj ankuesit nuk konstatohet fakti se të njëjtit i është cenuar ndonjë e drejtë që buron nga marrëdhënia e punës, ngase Komisioni Disiplinor nuk ka marr asnjë vendim përfundimtar mbi bazën e të cilit do të mund të konstatohet fakti se ankuesi është përgjegjës për shkelje të rënda disiplinore, dhe po ashtu me asnjë dispozitë të ligjit material nuk është përcaktuar fakti se me rastin e inicimit të procedurës disiplinore në rastet kur ajo përfundon në favor të palës (subjektit) ndaj të cilës është iniciuara procedura, mund të ndërmerren veprime ndaj iniciuesit të procedurës disiplinore.*

Po ashtu, Kolegji i Këshillit thekson faktin se mbi bazën e dispozitave të aplikuara nga nenin 59 paragrafi 3 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: “3. Komisioni disiplinor fillon procedurën: 3.1. me kërkesë të mbikëqyrëses/it të drejtpërdrejtë të nëpunëses/it civil; 3.2. bazuar në të gjeturat dhe/apo rekomandimet e çdo organi tjetër publik ose njësie me kompetenca kontrolli administrativ, inspektimi financiar apo auditimi, ose të çdo zyrtareje/i tjetër brenda institucionit, si dhe me kërkesën e qytetares/it; 3.3. me nismën e çdo anëtare/i të komisionit, mbi bazën e dyshimit të bazuar për kryerjen e një shkeljeje disiplinore’’, thekson faktin se nëpunësit civil apo çdo zyrtar brenda institucionit ka të drejtë të parashtojë kërkesë pranë Komisionit Disiplinor për inicimin e procedurës disiplinore ndaj ndonjë zyrtari apo nëpunësi në kuadër të institucionit përkatëse, gjegjësisht organi përgjegjës për shqyrtimin e procedurave të iniciuara disiplinore është Komisioni Disiplinor pranë organit të punësimit, siç parashihet edhe me ligjin material dhe kuadrin nënligjor në fuqi.

Kështu që, nga ajo që u tha si më lartë, Kolegji konstaton se në rrethanat e rastit konkret nuk janë plotësuar kushtet ligjore për pranueshmërinë e ankesës në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 ndërlidhur me nenin 124 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe se duke u mbështetur në dispozitat e nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi që të hedhë poshtë ankesën si të palejueshme, siç është përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**Lënda:A.nr.153/2026, datë 31/03/2026**

**Avdyl BEKTESHI**

\_\_\_\_\_  
**Procesmbajtës**

**Arben MEHMETI**

\_\_\_\_\_  
**Kryetar i Kolegjit**

**Vendimi i dorëzohet:**

- Ankuesit A.Q;
- Udhëheqëses së Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Drejtësisë, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së